

SOCIAL AND INDIVIDUAL CONTRADICTIONS IN MIGJENI'S LITERATURE

KUNDËRTHËNIET SHOQËRORE DHE INDIVIDUALE NË VEPRËN E MIGJENIT

Esmije VESELI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: esmiye.veseli@unite.edu.mk

Abstract

In Albania, in the 1930s, great turns took place, both in everyday life and in various literary theoretical creations, aimed at the birth of new poetics. This was a time of igniting numerous controversies, aimed at bringing about change in society, but also in the literary world, as long as social, moral, and traditional conventions, oppression, exploitation, human mistreatment, fierce class struggle, etc., were dominant. The message was intended to convey the message, in the form of an insurgent cry for the situation created. Such theoretical groupings demanded that the written word approach reality, and have solidarity with the poor, oppressed, and despised peoples.

Keywords: *Contradictions, existentialism, tradition, reforms, power, individual, etc.*

Përmbledhje

Në Shqipëri, në vitet e '30 ndodhën kthesa të mëdha, si në jetën e përditshme ashtu edhe në krijimet e ndryshme teorike letrare, që synonin lindjen e një poetike të re. Kjo ishte një kohë e ndezjes së polemikave të shumta, që synonin sjelljen e ndryshimeve në shoqëri, por edhe në botën letrare, për sa kohë ishin dominuese konvencat shoqërore, morale e tradicionale, shtypja, shfrytëzimi, keqtrajtimi i njeriut, lufta e ashpër klasore etj. Synohej që përmes fjalës të përçohej mesazhi, në formë të një klithje kryengritëse për situatën e krijuar. Grupimet e këtilla teorike kërkonin që fjala e shkruar t'i qasej realitetit, të kishte një solidarizim me njeriun e varfër, të shtypur dhe të përbuzur.

Fjalët kyçe: *Kundërthëniet, ekzistencializmi, tradita, reformat, pushteti, individi etj.*

Hyrje

Një ndër shkrimtarët e kësaj periudhe, që në mënyre kategorike u ngrit hapur kundër formave të vjetra, kundër ligjeve që dëmtonin shpirtërisht shoqërinë shqiptare, ishte pikërisht Migjeni, i cili, pa asnjë lloj rezerve, u bëri ballë sfidave shoqërore. Në platformën e tij poetike ai shtroi, në mënyrë më të hapur, problemin e ekzistencës, duke na paraqitur, shkallë-shkallë, gjendjen e popullit shqiptar në të gjitha sferat.

Sipas Sabri Hamitit, *Migjeni bëhet autori më i thellë i kohës, sepse në veprën e vet zbrit shkallë-shkallë nga paraqitja dhe trajtimi social i jetës, në botën intime dhe individuale të personazhit*.⁸² Ai nuk i idealizoi rregullat kanunore, ashtu siç kishte ndodhur në periudhën e kaluar, edhe pse këto rregulla kishin krijuar një traditë të thellë në krijimtarinë artistike që ekzistonte brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Rezultatet dhe diskutimi

Sipas bashkëkohësit të tij, Kristaq Tutullanit *Migjeni solli në truallin tonë një frymë të re poetike. Të re në çdo pikëpamje, motive të reja, shprehje të reja, horizonte të reja, melodi të reja*.⁸³ Një pohim mbresëlënës, por duhet shtuar se Migjeni, që në fillim, do të ndeshej me situata të palakmuara, me rrugë plot labirinte, me batica e zbatice, me divergjenca e polemika të thella, mirëpo pa hequr dorë nga synimi i tij deri në fund të jetës. Ai, fizikisht i dobët, por shpirtërisht i fortë, i matur, i vendosur, nëpërmjet artit të tij arriti që të shpërfaqte kontradiktat e ndryshme të kohës, të shoqërisë dhe njeriut.

Nuk është vetëm Migjeni që shprehu pakënaqësinë ndaj realitetit, ndaj botës së vjetër, sepse këtë synim e kishin edhe shkrimtarë tjerë të viteve 30-ta, porse ky besonte te një e ardhme më e mirë, një botë me përmasa të tjera nga ajo e vjetra, edhe pse shpeshherë, reflektonte nota pesimizmi kur analizonte më mirë situatën, madje e humbiste besimin. Këtë reflektim ai e shprehu në mënyrë shumë artistike, me një diskurs të ri, me një art të veçantë, me një gjuhë figurative të veçantë. *Protesta dhe revolta e Poetit të posalindur ishin diçka e re për ata që idealizonin të vjetrën, injoronin të tashmen dhe atyre që urrenin të ardhmen*.⁸⁴

Për nga përmbajtja tematike, shkrimet e Migjenit ndahen në dy plane: në njërin plan flet për jetën e vështirë si pasojë e skamjes, teksa në planin tjetër demaskon moralin e rrejshëm, hipokrizinë e njerëzve që e kishin marrë misionin ta përfaqësonin kombin, edhe atë të elitave kulturore. Për sa i përket Migjenit mund të thuhet se për të shpesh janë shfaqur dyshime në shumë aspekte. Çështja e revolucionit u keqkuptua dhe u keqinterpretua nga bashkëkohësit dhe studiuesit dhe në njëfarë mënyre tingëllon si fyerje e drejtpërdrejtë ndaj këtij shkrimtari. Shpesh herë gjykohej ashpër nga studiuesit kur përmend çlirimin e njerëzve prej të gjithë fatkeqësive të natyrave të ndryshme, teksa kjo dukej e pamundur kur bëhej fjalë për një ambient të shfrenuar.

Tiparin tjetër që ia veshin pa të drejtë është se Migjeni qenkësh pesimist për ardhmërinë e vendit, përfundime këto që zgjerohen edhe rrënjosen thellë. Mirëpo, këto përfundime, në shumicën e rasteve vijnë si pasojë e vlerësimit të krijimtarisë së Migjenit nëpërmjet metodave jashtë letrare. Pra, kemi një përqendrim të madh vetëm në aspektin tematologjik dhe jo të poetikës së tij. Për aq sa mund të hasim tone pesimiste, po aq shihet edhe optimizmi në krijimtarinë e tij letrare. Studiuesi Mensur Raifi konsideron se në *krijimtarinë e tij shihet mjaft qartë optimizmi i tij sinqeriteti kur shpreh dashurinë ndaj njeriut, dhembshurinë ndaj të varfërve, kujdesin ndaj të dobëtëve, rezistencën ndaj së keqes, shpirtin luftarak, kryengritës, revoltues, revolucionar* (...).⁸⁵

Megjithatë, edhe sikur krijimtaria e tij të përshkohej tërësisht nga tone pesimiste, ajo prapëseprapë mund të ishte një kryevepër e letërsisë, ashtu sikurse kemi shumë raste në letërsinë botërore. Andaj, tonet pesimiste apo optimiste nuk e dëmtojnë një krijimtari letrare. Elementet e këtilla, si zakonisht, janë theksuar nga kritika ideologjike.

⁸² Sabri Hamiti, *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 311.

⁸³ Kristaq Tutulani, *Shkrime të zgjedhura*, Tiranë, 1966, f. 93.

⁸⁴ Migjeni, *Vepra 4, Kritikë (Nonda Bulka, Millosh Gjergj Nikolla)*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 275.

⁸⁵ Mensur Raifi, *Fan Noli dhe Migjeni*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 165.

Duhet thënë se Migjeni donte që njeriu i thjeshtë, pra qytetari, civili, të ishte faktori kryesor i shoqërisë, prej nga edhe do të niset dhe do të depërtojë në botën e manifestimeve për një jetë më të mirë, thjesht për të qenë njeriu në qendër të vëmendjes. Ai kërkonte një shoqëri në shërbim të qytetarit, një shoqëri humane dhe çliruese dhe jo një shoqëri shfrytëzuese dhe ngulfatëse. Ai mbetet një poet që angazhohet estetikisht dhe jo si njeri veprimi në ndryshimin e realitetit ekzistues. Depërton thellësisht në filozofinë njerëzore, në jetën e njeriut, në botën e tij, në thellësitë e qenies. Ai nuk duron maska.

Njeriu i Migjenit paraqitet lakuriq, ashtu sikurse është i pazbukuruar i pa himnizuar. Me të gjithë problemet e tij ekzistenciale. Me gjendjen reale dhe mungesën e një shprese për shkak të rrethanave socio-historike. Njeriu migjenian e do punën, por ajo i mungon. Kështu e arsyeton vetveten personazhi Kola te *“Bukën tonë të përditshme falna sot”* ose lypësi që bëhet objekt talljeje.

Kur autori trajton pozitën e gruas këtë e bën nëpërmjet skenave rrëqethëse. Ajo paraqitet herë si nënë e ndershme e përkushtuar ndaj familjes, herë si “një grua e përdalë”. Ajo pranon poshtërimin jo për shkak të dëshirës dhe epshit, por për shkak të sëmundjes së të birit. Është mjerimi që shtyn femrat drejt një çnderimi, që Migjeni e paraqet nëpërmjet Lukes në *“Historia e njenës nga ato”* dhe nënës së Lilit në *“Bukën tonë të përditshme falna sot”*. Sipas Migjenit, pavarësisht një tradite mbizotëruese që e ka ngritur në mit nderin femëror, janë pikërisht rrethanat shoqërore që e detyrojnë femrën të pranojë prostituimin për shkak të mbijetesës. Prostituimi nuk është një zgjedhje personale, as i konceptuar si një profesion përfitimi, por një mundësi mbijetese.

Edhe në këtë rast fajet nuk qëndrojnë te individi, por te shoqëria, e cila nuk arrin që të krijojë një mirëqenie sociale. Migjeni, gjithashtu, revoltohet me pozitën e mjeruar të femrës shqiptare, të cilën e koncepton si gjithë femrat e vendeve të zhvilluara, të çliruar nga kodet e ngurta të traditës. Por ai, sikurse e hasim në gjithë krijimtarinë letrare, shkakun kryesor e sheh te mjerimi, si burim i të gjitha të këqijave njerëzore. Njeriu bëhet viktimë e shoqërisë *“që bashkë me qumështin e nënës mori urrejtjen dhe dëshirën për hakmarrje kundër kësaj bote të padrejtë”*⁸⁶. Çfarë faji ka Luli i Vocër që dëshiron të jetojë jetën sikurse moshatarët e tij?

Çfarë faji ka Lili që i është bërë fiksion buka e bardhë? Çfarë faji ka Zeneli, talenti dhe aftësitë e të cilit nuk i duhen askujt? Çfarë faji ka Lukja që bie viktimë e shoqërisë? Çfarë faji ka lypësi që me një këmbë të paralizuar mundohet ta nxjerr kafshatën e bukës, teksa duron fyerje dhe poshtërime të ndryshme? Të gjithë janë të pafajshëm, kurse shkakun kryesor i vuajtjeve të tyre është mjerimi, i cili kishte pushtuar realitetin shqiptar të viteve ‘30, por që ka pushtuar edhe shumë realitete vitesh të tjera pasardhëse.

Migjeni nuk kursen askënd. Ai ka hyrë në luftë me të gjitha dimensionet e shoqërisë. Akuzon kishën, fenë, klasat udhëheqëse, elitat kulturore, ngrihet kundër kodeve tradicionale, që janë të rrënjosura thellë në vetëdijen e njerëzve. Ai godet dhe vetëm godet. Godet sepse kudo sheh hipokrizi, moral të rrejshëm, mungesë humanizmi dhe solidariteti, çekuilibre psikologjike dhe shoqërore. Nuk ka tek ai kurrfarë kompromisi. Ai shkon atje ku e shpie ndjenja e tij, shikimi i tij, intuita e tij, vëzhgimi i tij i thellë dhe teksa ndjek këtë itinerar mbetet i pagabueshëm. Është jashtë klaneve kulturore, politike, shoqërore.

Ai nuk hesht teksa një njeri epik përkulet përpara një zyrtari të thjeshtë për një kokërr misri. Ai nuk bën hyjneshë a burrneshë një grua të konceptuar kështu nga mitologjia tradicionale, por sheh një njeri që shet dinjitetin për të mbijetuar. Migjeni shpalos një botë tragjike, të egër, aspak dashamirëse, tejet ngulfatës, por njëkohësisht, ai shpreson te ndryshimi. E di se kjo gjendje nuk mund të jetë pafundësisht kështu. E ndjen se do të ndryshojë, por paraprakisht, duhet të konceptohet ndryshe në vetëdijen e njerëzve. Pra, së pari duhet që të ndryshojë njeriu, vizioni i tij për botën, e më pastaj të ndryshojë bota.

⁸⁶ Migjeni, *Vepra 4, Kritikë*, Rilindja, Prishtinë, 1977, fq. 179.

Ai i vë njeriut një pasqyrë përpara për ta parë jo pamjen e tij të rrejshme, por pamjen e tij të vërtetë. Të njohë vetveten dhe më pas ta ndryshojë. *Poeti konkludon se njeriu s'duhet të bjerë në pesimizëm kur njihet me këtë vartësi fatale, sepse bart në vetvete forca të brendshme që mund ta ngrenë mbi çdo qenie tjetër natyrore, që mund ta bëjnë të lirë. Migjeni konceptin e lirisë e mbush me përmbajtje të pasur social-humanitare.,,Liri- edhe gaforja gëzon, por gafore është''kurse Poeti kërkon liri ndërgjegje, liri mendimi, liri krijimi.*⁸⁷ Njeriu për Migjenin ishte gjithçka, prandaj u bë subjekti kryesor në gjithë krijimtarinë letrare të tij, duke iu referuar gjendjes sociale që sundonte dhe duke shpalosur njëkohësisht altruizmin e tij. Migjeni besoi verbërisht te njeriu i masës, duke u bërë edhe ai pjestar i pandashëm i kësaj lëvizjeje, dhe duke synuar për një të ardhme më të mirë.

Një tjetër dimension tepër i diskutuar është edhe raporti ndërmjet artistit dhe pushtetit ku janë trajtuar shumë herë nga studiuesit e sistemeve të ndryshme kulturore. Kjo rezultoi se ato përgjatë gjithë historisë njerëzore, veçanërisht historisë së letërsisë, kanë qenë tejet të acaruar. Letërsia si një realitet i mundshëm, me mjetet e saj shprehëse, pra fjalën, gjuhën, gjithmonë i është kundërvënë gjuhës së pushtetit. Ky raport është trajtuar shpesh, sa herë që janë bërë studime edhe për Migjenin. Njëri nga ata që trajton raportet e këtilla artist pushtet është edhe Ismail Kadareja, sipas të cilit Migjeni kishte shenjë të vendosur, si ato drunjtë e shënuar për t'u prerë.

Detyrimisht, godiste themelet e një mendësie të vjetër, nuk mund që të kalonte pa u vënë re nga pushteti dhe detyrimisht të paraqiste një rrezik për të, sepse e godiste pushtetin në pikën më të dobët. Ia kishte gjetur thembrën e Akilit. Lufta e Migjenit me pushtetin nuk ishte luftë e një veprimtari. Ai nuk ka mjete të tjera refuzuese përveç artit të tij. Lufta e tij zhvillohej në planin estetik. Ai e refuzonte në mënyrë estetike një pushtet i cili nuk arrinte që të siguronte ekuilibra socialë, nuk arrinte që të krijonte një sistem shoqëror që do t'i përgjigjej njeriut, nuk arrinte që të ishte pjesë e një mendësie të re, që po krijohej pas themelimit të shtetit të pavarur shqiptar.

Migjeni u ndie i goditur nga pushteti i Mbretit Zog, kurse shkaku kryesor i kësaj goditjeje ishte vepra e tij artistike, sepse e godiste fuqimisht pushtetin e ndërtuar mbi ideale, mbi mitologjitë tradicionale. Migjeni nuk kishte antipati personale ndaj Mbretit Zog, sikurse mund ta kishte Fan Noli, sepse ai nuk bënte luftë për kurrfarë pushteti. Por, arti i tij ishte refuzues ndaj sistemit që po ndërtohej. Migjeni kërkonte që në qendër të gjithçkaje të ishte njeriu. Të ngjallej humanizmi dhe solidariteti, të ruhej dinjiteti i tij, të zhdukej përçmimi, veçanërisht ai institucional. Migjeni po cenonte një imazh të rrejshëm dhe tejet të përhapur. Këtë e bënte nëpërmjet poetikës së tij të veçantë.

Ai, nëpërmjet letërsisë, depërtoi aty ku nuk depërtuan publicistët shqiptarë të kohës, arriti që ta dekompozonte këtë sistem deri në detaje. Madje, nuk paraqiste vetëm pamjen e tij të jashtme, por edhe pamjen e brendshme të njeriut të kohës. Ai, duke i treguar njeriut gjendjen reale, në njëfarë mënyre, sikur i bënte thirrje që të zgjohej dhe të kërkonte ta ndryshonte këtë gjendje mjerimi dhe sfiliteje. Ja disa nga arsytet që të ishte i rrezikshëm për shtetin, i cili jo rastësisht, censuroi librin e tij.

Te skica *“Novelë mbi krizë”*, pa kurrfarë hezitimi godet paaftësitë e shtetit dhe administratën shtetërore që lindi prej *“recetave të Parisë”* dhe e shndërroi shtetin në një muzeum.⁸⁸ Aparatura shtetërore udhëhiqej nga njerëz të paaftë dhe nuk dinte ç'të bëj dhe si ta vendosi çashtjen e krizës ndërsa varfëria e madhe e kish bamë shumë njerëz të marrin shkopin e lypsisë dhe shumë gra, me foshnje në gji të shtrinjë dorën për lëmosh . Por për këtë nuk u tundte Paria e shteteit X.⁸⁹

⁸⁷ Alfred Uçi, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, Vatra, Shkup, 2003, f. 199.

⁸⁸ Migjeni, *Prozë 2*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 21.

⁸⁹ Po aty, f. 20.

Pikërisht ky ishte realiteti i këtij shteti, andaj Migjeni ndihej shumë i revoltuar dhe i zhgënjyer nga këto pamje rrënjëthënëse. Prandaj, ai kërkon një shtet dalëzotës për qytetarët e saj. Shoqëria ekzistuese nuk përputhej me konceptin e tij human. Ajo ishte e shpërfytyruar deri në ekstrem. Ai nuk zgjodhi heshtjen përballë këtij shfityrimi, por revoltën, rebelimin. Letërsia e tij ishte herezia më e madhe për pushtetin, prandaj ishte edhe e rrezikshme dhe u dënua *nga një arme e re, banale në pamje, por e vdekshme si asgjë tjetër – censura*”, thotë Ismail Kadare.⁹⁰

Përfundimi

Migjeni e shikoi realitetin shqiptar me syrin e një opozitari, me syrin e një Prometheu. Ai distancohej përherë nga çastet kur kërkohej mëshirë dhe kurrë si kishte shkuar ndërmend që ndonjëherë do të kërkonte mëshirë, sepse e kishte quajtur „bijë bastarde e etnëve dinakë, prandaj, sa ishte gjallë, nuk e pa veprën e tij të botuar. Meqenëse Migjeni në këtë rast përbënte opozitën përfitoi shumë, sepse iu dha rasti, në mënyrë të drejtpërdrejtë ta njohë realitetin shqiptar. Prandaj, e gjithë vepra e tij është dëshmi e kohës së një realiteti të shprishur në të gjitha sferat e saj si në atë politik, shoqëror, ashtu edhe ekonomik. Letërsia shqiptare humbi shumë me vdekjen e këtij shkrimtari, për shkak se humbi një personalitet të shquar dhe shumë të zëshëm në letrat shqipe.

Referencat

- [1]. Migjeni, *Vepra* (Zgjedhur e redaktuar nga Razi Brahimi), Naim Frashëri, Tiranë, 1972.
- [2]. Migjeni, *Vepra* (Kompleti i redaktuar nga Rrahman Dedja, 1. Poezi, 2. Prozë, 3. Migjeni-portret, 4. Monografi, Kritikë) Rilindja, Prishtinë, 1977.
- [3]. Migjeni, *Poezi*, Naim Frashëri, Tiranë, 1979.
- [4]. Migjeni, *Veprat* (Mbledhur dhe përgatitur nga Skënder Luarasi) Naim Frashëri, Tiranë, 1957.
- [5]. Migjeni, *Poezi e prozë*, EBT i RSS - Beograd, 1963.
- [6]. Aliu, A. *Migjeni*, Shqyrtime. Prishtinë, 1974.
- [7]. Elsie, R. *Migjeni, Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997.
- [8]. Fetiu, S. *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Prishtinë, 1984.
- [9]. Raifi, M. *Fan S. Noli dhe Migjeni*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- [10]. Uçi, A. *Pesë të mëdhenjtë të letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, Vatra, Shkup, 2003.
- [11]. Kadare, I. *Migjeni ose uragani i ndërprerë*, Tiranë, 1989.
- [12]. Hamiti, S. *Molla e ndalueme*, Vetëdija letrare, Prishtinë, 1989.

⁹⁰ Ismail Kadare, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqiptare*, Tiranë, 1989, f. 95.